

VENDIM
Nr. 672, datë 29.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, miratuar me vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, neni 45, “Dispozita kalimtare” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 45

Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për territoret administrative të bashkive:

- a) kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi do të merren në shqyrtim nga autoritetet përgjegjëse vetëm për zhvillime të propozuara në zona të territorit vendor, për të cilat janë miratuar dokumentet e planifikimit të territorit, sipas hartës bashkëlidhur, me përjashtim të zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezit bregdetar, sipas vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, në të cilat çdo ndërtim i ri do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.
- b) për të gjitha zonat e tjera, që nuk përfshihen në shkronjën “a”, të këtij neni, kërkesat për leje ndërtimi do të merren në shqyrtim nga autoritetet përgjegjëse vetëm sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.
- c) për objektet mbi 6 kate, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, leja e ndërtimit jepet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Harta me territoret vendore që kanë dokumenta planifikimi të miratuara

